

Drejtonia e Regjistrimit
IT

Tiranë, më 24.12.2010

SHOQËRIA TREGTARE "GREEN POWER" SHPK (në likuidim)
LIKUIDATORI TEIT GJINI



FTESË PËR KREDITORËT E SHOQËRISË "GREEN POWER" SHPK
(Njoftimi i dytë)

Me datë 24.12.2010 Likuidatori i shoqërisë "Green Power" SHPK z. Teit Gjini, në respektim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit njoftimin e parë *Ftesë për kreditorët e shoqërisë "Green Power" SHPK*, njoftim i cili është publikuar në faqen zyrtare të QKR më datë _____.

Në respektim të nenit 195 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dërgohet Njoftimi i dytë *Ftesë për kreditorët e shoqërisë "Green Power" SHPK*, si më poshtë vijon:

Më datë 20.05.2010 Asambleja e përgjithshme e Shoqërisë "Green Power" SHPK ka vendosur:
".....4. Nisjen e procedurave të likuidimit të shoqërisë "Green Power" SHPK.
5. Emërimin e z. Teit Gjini, ekspert kontabël i regjistruar me numër licence 68, në detyrën e likuidatorit të shoqërisë "Green Power" SHPK...".

Vendimi i mësipërm është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, më datë 15.10.2010 dhe ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit të kësaj shoqërie në gjendjen e aftësisë paguese.

Të dhënat e shoqërisë që likuidohet "Green Power" SHPK

Shoqëria "Green Power" SHPK, është regjistruar si person juridik, me vendim Nr. 38967, datë 20.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Bulevardi "Zhan D'Ark", pallati prapa Ministrisë së Jashtme.

Shoqëria "Green Power" SHPK, është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane, me NIPT K72016001R.

Kapitali i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqind mijë) lekë i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1.000 lekë secila.

Ftesa për kreditorët e shoqërisë

Në bazë të Nenit 195 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likuidatori i shoqërisë, z. Teit Gjini, fton kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj.

Në bazë të Nenit 195 të ligjit të sipërcituar, pretendimet e kreditorëve duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dytë të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), në zyrën e likuidatorit Teit Gjini, Rruga "Pjeter Bogdani", pallati 39/1, ap.4.4, Tirane.

Numrat e kontaktit të likuidatorit janë: Tel. +355 4 2 222 889 / Fax. +355 4 2 222 889.

Likuidatori i shoqërisë "Green Power" SHPK (në likuidim)

TEIT GJINI

